

Kushtet e përgjithshme të biznesit / Kushtet e përgjithshme të pjesëmarrjes

1. Kushtet e përgjithshme të pjesëmarrjes

- 1.1.** Kurset për të rritur janë të përshtatura për të rritur. Të miturit nga mosha 16 vjeqare mund të marrin pjesë në këto kurse vetëm pas konsultimit me drejtorinë e qendrës.
- 1.2.** Qendra për Mësimin e Gjuhës mbanë përgjegjësi dhe të drejtën për ofrimin e numrit të plotë të orëve të mësimi sipas nivelit të kursit.
- 1.3.** Në marrëveshje me kursantët dhe me pajtimin e shumicës së pjesëmarrësve të kursit, orët e anuluar mund të zëvendësohen edhe jashtë orarit të rregullt të kursit dhe ditëve të pushimit ose të shtunëve.

2. Kushtet e pagesës

- 2.1.** Pas regjistrimit kursanti njoftohet për vendin e rezervuar në kursin përkatës. Në këtë njoftim atij i jepet një afat, brenda të cilit duhet të bëjë pagesën e tarifës së kursit dhe atë brenda tri ditëve pas fillimit të kursit
- 2.2.** Në rast se pagesa e plotë e tarifës ose pagesa e këstit përkatës nuk bëhet në kohë, kursanti e humbë të drejtën e frekuentimit të kursit, përveq nëse kursantit me kërkesën e tij i lejohet zgjatja e afatit nga Drejtoria e Qendrës për Mësimin e Gjuhës.
- 2.3.** Tarifa e kursit duhet të paguhet me transfertë bankare.

3. Tarifat

- 3.1.** Pjesë e marrëveshjes janë tarifat e vlefshme në momentin e regjistrimit në kurs, të cilat janë paraqitur në fletëpalosjen aktuale të Qendrës për Mësimin e Gjuhës.
- 3.2.** Në tarifat e kursit përfshihet kostoja e librave për mësim.
- 3.3.1.** Kurset në Qendrën për Mësimin e Gjuhës rezervohen vetëm si kurse të plota sipas fletëpalosjes së ofertës dhe faturohen sipas tarifave të plota të përcaktuara sipas nivelit të kursit. Nëse pagesa e plotë e tarifave të kursit nuk paguhet brenda afatit të caktuar, atëherë Qendra për Mësimin e Gjuhës mbanë të drejtën për të lajmëruar këtë tek organet përgjegjëse.
- 3.3.2.** Përjashtim në këtë rast përbejnë kursantët, të cilëve duke u bazuar në testin vlerësues u është propozuar të bashkohen në një kurs i cili tanimë është duke u mbajtur.
- 3.4.** Vijimi i rregullt i kursit është nën përgjegjësinë e kursantit. Kursantit nuk i takon të kërkojë kompenzimim e orëve mësimore të humbura (në formë të zbritjes në çmim apo të kompenzimit të orëve mësimore), si pasojë e vetëshkaktuar.
- 3.5.** Nëse kursanti dëshiron të ndryshojë kursin (ndryshim datash ose kursi), ndryshimi i parë bëhet pa pagesë. Për çdo ndryshim tjetër mbahet një tarifë prej 10 % e tarifës së kursit. Ndryshimi i kursit në një nivel tjetër, me rekomandimin e mësuesit përkatës ose si rezultat i një testimi të mëvonshëm të njohurive, bëhet pa pagesë shtesë.
- 3.6.** Kursantët e Qendrës për Mësimin e Gjuhës në Prishtinë pas kursit të parë të vijuar dhe të paguar përfitojnë një zbritje prej 10% në tarifën e kursit të nivelit në vazhdim. Pas tre muajve kjo e drejtë për zbritje shuhet. Nëse Qendra për Mësimin e Gjuhës brenda këtyre tre muajve nuk arrinë të ofrojë një kurs në nivelin e rradhës, atëherë ky afat zgjatet në gjashtë muaj. Kjo zbritje vlenë vetëm nëse kursanti nuk është duke përfituar nga një zbritje tjetër.
- 3.7.** Familjarëve të shkallës së parë, të cilët jetojnë në të njëjtën amvisëri, u lejohet zbritja familjare.
- 3.7.1.** Nëse dy apo më shumë kursantë nga e njëjta familje ndjekin njëkohësisht një kurs të gjuhës, personi i parë paguan tarifën e plotë sipas nivelit të kursit, ndërsa anëtarët e tjerë të familjes përfitojnë një zbritje prej 25% në tarifat e kurseve përkatëse.
- 3.8.** Kursantët e Qendrës për Mësimin e Gjuhës përfitojnë një zbritje të njëherëshme prej 50% në tarifat e provimit të Institutit Goethe, në provimet e rradhës sipas nivelit të kursit. Zbritja vlenë vetëm njëherë dhe mund të shfrytëzohet deri në dy terminet e rradhës të mundshme, pas përfundimit të kursit të nivelit përkatës.

4. Çregjistrimi

- 4.1.** Në rast se kursanti nuk mund të ndjekë kursin, vlejën kushtet e mëposhtme të çregjistrimit: .
 - 4.1.1.** Në rast çregjistrimi deri ditën e tretë të punës pas fillimit të kursit, kur kursi zgjatë mbi 7 javë dhe deri ditën e parë të kursit të të gjitha kurset më të shkurtra mbahet një tarifë administrative prej 20 % e tarifës së kursit.
 - 4.1.2.** Në rast çregjistrimi të mëvonshëm kthimi i pagesës apo i transferimit nuk është më i mundur, pavarësisht nëse kursi është ndjekur apo jo.
- 4.2.** Njoftimi për çregjistrimin duhet paraqitur me shkrim në administratën e Qendrës për Mësimin e Gjuhës. Si datë çregjistrimi vlen data e paraqitjes së njoftimit për çregjistrim.
- 4.3.** Në rast se Qendra për Mësimin e Gjuhës e anulon një kurs, kursantëve të cilët e kanë kryer pagesën u kthehet tarifa e plotë e paguar. Kursanti në këtë rast nuk do të ketë kërkesa tjera ndaj Qendrës për Mësimin e Gjuhës.

5. Ndarja e kurseve / madhësia e grupeve

5.1. Përcaktimi i nivelit bëhet mbi bazën e testimit të njohurive në Qendrën për Mësimin e Gjuhës. Për ish-kursantët ose personat që paraqesin certifikata të Institut Goethe përcaktimi i nivelit mund të bëhet bazuar në certifikatën e pjesëmarrjes në kurs ose të certifikatës së provimit, nëse data e lëshimit të tyre nuk i kalon 6 muaj.

5.2. Kurset tona kanë minimalisht 8 dhe maksimalisht 16 pjesëmarrës. Në rast se në fillim të kursit numri i kursantëve është shumë i vogël, Qendra për Mësimin e Gjuhës në Prishtinë ka të drejtë të anulohet këtë kurs ose të ndryshohet datën/orën e fillimit të tij. Në këtë rast u ofrojmë kursantëve mundësinë e kalimit në një kurs tjetër ose të kthimit të tarifës së plotë të paguar për kurs.

5.3. Qendra për Mësimin e Gjuhës e mbanë të drejtën, të caktoj dhe në rast nevojë të ndërroj mësimdhënësin dhe gjithashtu të i bashkoj kurset në nivelin e njejtë. Edhe në këto raste kursantit nuk i takojnë kërkesa tjera ndaj Qendrës për Mësimin e Gjuhës.

6. Dëshmitë e pjesëmarrjes dhe vazhdimi i nivelit të rradhës

6.1. Një dëshmi pjesëmarrjeje i lëshohet secilit kursant i cili ka vijuar orët e mësimit dhe i ka kryer të gjitha obligimet ndaj Qendrës për Mësimin e Gjuhës. Në dëshminë e pjesëmarrjes do të evidentohet numri i orëve mësimore të vijua nga kursanti. Mësimi përlllogaritet mbi bazën e orëve mësimore prej 45 minutash.

6.2. Lëshimi i një dublikate bëhet vetëm njëherë, pas kërkesës me shkrim nga ana e kursantit. Pas përfundimit të afatit maksimal prej dy vitesh për ruajtjen e dokumentacionit lëshimi i një dublikate apo ruajtja e certifikatës origjinale është e pamundur.

6.3. Parakusht për vijimin e kursit të nivelit të rradhës është vlerësimi i mjaftueshëm gjatë testeve të rregullta gjatë kursit të nivelit aktual. Këtu vlenë mesatarja e arritjes prej 60%.

7. Detyrimet e kursantit

Kursanti ka për detyrim të zbatojë rregulloren e kursit dhe rregulloren e brendshme të Qendrës. Kursanti ka për detyrim të mënjanoj çdo sjellje të papërshtatshme e cila mund të dëmtoj pronën ose procesin e punës së të tretëve (mësimdhënësve, kursistëve tjerë, stafit ose vizitorëve të Qendrës për Mësimin e Gjuhës). Në rast të shkakimit të dëmit nga ana e kursantit me qëllim, Qendra për Mësimin e Gjuhës mbanë të drejtën e kërkesës së kompenzimit ndaj kursantit.

8. Përgjegjësia e Qendrës për Mësimin e Gjuhës / forcat madhore

Qendra për Mësimin e Gjuhës dhe punonjësit e saj mbajnë përgjegjësi për dëme të shkaktuara nga veprime të qëllimshme ose nga pakujdesi. Qendra për Mësimin e Gjuhës nuk mban përgjegjësi për mosofrimin e shërbimeve të saj për shkak të forcave madhore (psh. në rast katastrofash natyrore, zjarri, përmytjesh, lufte, urdhëri nga institucionet shtetërore dhe në të gjitha rrethanat e tjera) të cilat janë jashtë kontrollit të palëve në marrëveshje.

9. Siguria e të dhënave

Kursanti me rastin e regjistrimit të kursit pajtohet, që të dhënat e tij të regjistrohen në mënyrë elektronike për përdorim të brendshëm për mbarëvajtjen e procesit të regjistrimit, faturimit dhe të dëshmisë së vijimit të kursit.

Pajtohem me Kushtet e përgjithshme të pjesëmarrjes

Emri, Mbiemri: _____

Nënshkrimi

(Per të mitur: Emri, Mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës)

Vendi, data: